

BASHKIA KOLONJË
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

1. Autoriteti: Bashkia Kolonjë

Adresa	Sheshi “ Rilindja ”
Tel/Fax	+355 812 23173 ; 08122225 ; 2232
E-mail	bashkia.kolonje@gmail.com
Faqja e Internetit	http://www.kolonja.gov.al
2. Dhënie me qira të fondit pyjor dhe kullor me konkurim publik në pronësi të Bashkisë Kolonjë, Zona Kadastrale 3510, me nr, pasurie 416 në parcelën nr.97 Ekonomia Pyjore Qëndër Gramoz me vendndodhje në Njësinë Administrative Qëndër Ersekë, Fshati Starje, Bashkia Kolonjë, lloji kullote me sipërfaqe 25 ha.
3. Qëllimi i dhënies me qira të fondit pyjor dhe kullor me konkurim publik, në pronësi të Bashkisë Kolonjë Zona Kadastrale 3510, me nr, pasurie 416 në parcelën nr.97 Ekonomia Pyjore Qëndër Gramoz me vendndodhje në Njësinë Administrative Qëndër Ersekë, Fshati Starje, Bashkia Kolonjë, lloji kullote me sipërfaqe 25 ha, është dhënia në përdorim për zhvillim ekonomik, në fushën e energjive të rinovueshme, etj.
4. Konkurrimi do të zhvillohet më datë: 06.04.2023, ora 11:00, në Salla e Këshillit Bashkiak, Bashkia Kolonjë.
5. Çmimi dysheme i qirasë, është
Kullotë: 176,000 (Njëqindeshatëdhjetëegjashëmijë) lekë/ha në vit.
6. Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie do të jetë tej afatit 10 (dhjetë) vjet.
7. Ofertuesit janë të lutur të paraqesin vetëm një ofertë, në datën dhe orën e caktuar, dhe dokumentacionin si vijon :
 - a) Kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
 - b) Çertifikatën e regjistrimit dhe Ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë,
 - c) Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licensuar ku janë trajtuar të gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar, (i cili përmban hartën topografike me kordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000, ku të jenë evidentuar elementët kryesorë, si kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe cdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit);
 - d) Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
 - e) Të dhënat për kapacitetet teknike, stafin makineritë dhe paisjet që zotëron;
 - f) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
 - g) Nivelin e punësimit në veprimtari;
 - h) Raportin e vlersimit të ndikimit mjedis nga ekspertë të çertifikuar;
 - i) Çmimin e qerasë së ofruar për ha/vit;
 - j) Afati i qirasë.
 - k) Adresës e subjektit, telefonin, e-mail dhe faks.
 - l) Të ketë të kontraktuar një specialist të fushës ,ku në CV – në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë.

- m) Vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim,hetim në proces,detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve,
- n) Vërtetim për shlyerjen e taksave,tarifave dhe detyrimeve vendore për vitin 2021 dhe për vitin e fundit 2022 (këstet e maturuara),duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku ushtron/jnë aktivitetin.
- o) Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në cdo rast, Komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.
8. Oferta paraqitet në një zarf të mbyllur i cili duhet të përmbajë një kopje origjinale ose të noterizuar të dokumentacionit të ofertës dhe ku të përcaktohen qartë identiteti dhe adresa e personit, fizik apo juridik të interesuar dhe të dorëzohen në zyrën e Protokollit të Bashkisë Kolonjë, para orarit të hapjes së ofertave.
9. Sigurimi i ofertës
Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin e Sigurimit të Ofertës,
Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës duhet të jetë sa 2% e vlerës së ofertës
Llogaritja bëhet: Vlera e qirasë X ha X vitet e qirasë X 2%.
10. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas pikëve për kriteret e përcaktuara si më poshtë:
- | | |
|---|----------|
| a) Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet,(i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000,ku të jenë evidentuar elementët kryesorë,si kufijtë natyrorë,relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar,hartuar konform kërkesave të projektit)..... | 20 pikë. |
| b) Plani i biznesit dhe investimet që do të bëhen | 15 pikë. |
| c) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes..... | 25 pikë. |
| d) Nivelin e punësimit në veprimtari..... | 5 pikë. |
| e) Masën e qerasë për ha/vit | 35 pikë. |

11.Subjektet e interesuara për qiramarrje ose përfaqësuesit e tyre të pajisur me prokurë origjinale/fotokopje të noterizuar dhe dokument identifikimi mund të tërheqin dokumentat e konkurimit brenda 7 (shtatë) diteve nga data e shpalljes të këtij njoftimi, nga ora 10:00-14:00, pranë Zyrës së Financës në Bashkinë Kolonjë kundrejt tarifës 1000 (njëmijë) lekë. Konkurruesit të cilët nuk kanë tërhequr dokumentat nuk mund të marrin pjesë në procedurën konkurruese.

12.Dokumentacioni do të dorëzohet në sekretarinë e Bashkisë Kolonjë deri më datë 06.04.2023, para orës 11:00.